



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORË

VENDIM

Nr. 11, Datë 28.04.2017

PËR MIRATIMIN E VENDIMEVE PËR KALIMIN NË PRONËSI TE PASURIVE TË PALUAJTSHME TË NDËRTUARA DERI ME 10.08.1991, E TË TRUALLIT FUNKSIONAL TË TYRE, KUR NUK POSEDOHEN AKTE FITIMI PRONËSIE DHE PËR REGJISTRIMIN E TYRE.

Këshilli i Qarkut Vlorë i mbledhur sot më datë 28.04.2017 në zbatim të ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të VKM 608, datë 05.09.2012 "Për përcaktimin e procedurës së kalimit të pronësisë të pasurive të paluajtshme, të ndërtuara deri më 10.08.1991 e të truallit funksional të tyre, kur nuk posedohen akte fitimi pronësi, si dhe për regjistrimin e tyre", i ndryshuar si dhe të vendimeve të dërguara nga Bashkia Delvinë.

VENDOSI :

1. Të miratojë Vendimin Nr. 18/3, datë 19.12.2016 "Për kalimin në pronësi të pasurisë së paluajtshme të ndërtuar deri më 10.08.1991 dhe truallit funksional të saj" për subjektin Kërkues **Z. Kristaq Shomo (subjekti Z. Kristaq Shomo gjeneralitetet e subjektit sipas çertifikatës së vitit 1991)** për një objekt banimi (1 Kat) me sipërfaqe ndërtimi 95 m² dhe sipërfaqe truall funksional 200 m², me vendndodhje në lagjen "Lejla Malo", të qytetit të Delvinës, zona kadastrale 1464, nr. pasurie 11/23 që kufizohet nga Veriu me pasurinë 11/230, nga Jugu me pasurinë 11/95, nga Lindja me pasurinë 11/22 dhe nga perëndimi kufizohet me pasurinë 11/250 (rrugë), pasurinë 11/25 dhe pasurinë 11/248.
2. Të miratojë Vendimin Nr.19/3, datë 25.01.2017 "Për kalimin në pronësi të pasurisë së paluajtshme të ndërtuar deri më 10.08.1991 dhe truallit funksional të saj" për subjektin Kërkues **Znj. Katina Gunari (subjekti Znj. Katina Gunari gjeneralitetet e subjektit sipas çertifikatës së vitit 1991)** për një objekt banimi (1 Kat) me sipërfaqe ndërtimi 71 m² dhe sipërfaqe truall funksional 200 m², me vendndodhje në lagjen "Lejla Malo", të qytetit të Delvinës, zona kadastrale 1464, nr. pasurie 11/11 që kufizohet nga Veriu me pasurinë 11/11, nga Jugu me me rrugë lagjeje, nga Lindja me objekt banimi një katësh dhe nga perëndimi kufizohet me pasurinë 11/1
3. Të miratojë Vendimin Nr.21/2, datë 07.02.2017 "Për kalimin në pronësi të pasurisë së paluajtshme të ndërtuar deri më 10.08.1991 dhe truallit funksional të saj" për subjektin Kërkues **Z. Mefail Zenelaj (subjekti Z. Mefail Zenelaj gjeneralitetet e subjektit sipas çertifikatës së vitit 1991)** për një objekt banimi (1 Kat) me sipërfaqe ndërtimi 40 m² dhe sipërfaqe truall funksional 170 m², me vendndodhje në lagjen "9 Tetori", të qytetit të Delvinës, zona kadastrale 1464, nr. pasurie 4/61 që kufizohet nga veriu me rrugë automobilistike, nga jugu me Ish Ndërmarrjen e Përpunim Drurit dhe pasurinë nr. 4/50, nga lindja me pasurinë 4/139 dhe nga perëndimi me pasurinë 4/50 dhe rrugë automobilistike